



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr 654/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit R... L.L.C, me seli në Prishtinë , të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Legus”, me seli në Prishtinë, kundër debitorit K... F... sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners Sh.p.k – Blerim Prestreshi avokat në Prishtinë, duke vendosur sipas parashtrës së kreditorit për tërheqjen e Urdhrit Përmbartimor P.nr 993/20 të datës 16.12.20 të Përmbartuesit Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.08.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbartimit e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr 993/20 të datës 16.12.20 të Përmbartuesit Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, në çështjen përmbartimore të kreditorit R... L.L.C, me seli në Prishtinë kundër debitorit K... F... sh.p.k, me seli në Prishtinë, për shkak të tërheqjes së propozimit nga ana e kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Isa Shala, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit R... L.L.C, me seli në Prishtinë , ka caktuar urdhrin P.nr 993/20 me datën 16.12.20, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 4954 të datës 06.10.2020 me të cilin e ka urdhëruar debitorin K... F... sh.p.k, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, të paguaj shumën prej 2.6000.00 € (dy mijë e gjashtëqind euro) me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe regjistrimin, dhe shitjen e sendeve të paluajtshme deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit me datë 28.12.2020 prapësim ka paraqitur debitori K... F... sh.p.k, me seli në Prishtinë përmes të autorizuarit Blerim Prestreshi avokat në Prishtinë si dhe përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori përmes të autorizuarit të tij Shoqërisë së Avokatëve “Legus”, me seli në Prishtinë.

I autorizuari i kreditorit, me datën 14.01.2021, me anë të parashtresës, e ka njoftuar Përmbauesin Privat Isa Shala me seli në Prishtinë, se tërhiqet nga Urdhri Përmbaues P.nr 993/20 për faktin se Kompania M... i ka përmbushur obligimet në emër të debitorit dhe se nuk kanë interes që të vazhdojnë më tutje me procedurat.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 42 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbauese i cili përcakton se “ *Propozimi për përmbaues mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbauese pa pëlqimin e debitorit* ” dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton se “ *Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbaues organi përmbaues e përfundon përmbauesin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht* “, dhe duke vendosur sipas parashtresës së të autorizuarit të kreditorit këtë çështje përmbauese e përfundoi në tërësi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 654/22, datë 31.08.2022.

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.